

Fjalë përshëndetëse e Kryetares znj. Holta Zaçaj
Konferenca e Avokatit të Popullit me rastin e 25 -vjetorit të krijimit
Tema “Strukturat Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të
Drejtave të Njeriut: Praktikrat e mira dhe Përvojat e fituara”
25 Qershor 2025, Tiranë

E nderuar zj. Avokate e Popullit,
I nderuar z. Ministër i Drejtësisë,
Shkëlqesi ambasadorë,
Të nderuar të ftuar dhe pjesëmarrës,

Ndihem e privilegjuar të përshëndes këtë aktivitet jubilar, që shënon një moment të rëndësishëm në jetën institucionale të vendit– **përvjetorin e krijimit të Avokatit të Popullit**, i cili në këtë rrugëtim 25-vjeçar ka dëshmuar pjekuri institucionale, pavarësi dhe profesionalizëm, duke u bërë një faktor i rëndësishëm në forcimin e demokracisë dhe në ndërtimin e kulturës të të drejtave të njeriut në vend.

Në fjalën time ju drejtohem jo vetëm si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, por si qytetare dhe dëshmitare e ndërveprimit dhe ekuilibrit delikat dhe të tensionuar mes pushtetit dhe parimeve, mes zërit të shtetit dhe heshtjes së qytetarëve.

Në këtë ekuilibër të brishtë, Avokati i Popullit ka qëndruar me dinjitet të heshtur e të palëkundur. Emërtimi i tij nuk është simbolik dhe as stoli e demokracisë. Ai është një premtim kushtetues.

Le ta themi hapur: Avokati i Popullit nuk ka as buxhet rivalizues me organet e ekzekutivit, as fuqi legislative. E megjithatë, është një nga

institucionet më të fuqishme në një demokraci, sepse flet nga hapësira ku asnjë organ tjetër shtetëror nuk arrin: **ndërgjegjja njerëzore.**

Në një demokraci heshtja mund të jetë e rrezikshme. Ajo lejon padrejtësitë të marrin rrënjë. Dhe Avokati i Popullit flet aty ku të tjerë heshtin. Ai nuk është vetëm mbrojtës i të drejtave – është pasqyrë që i tregon shtetit jo atë që dëshiron të shohë, por atë me të cilën duhet të përballlet.

Le të mos harrojmë se ne nuk e trashëguam demokracinë – e ndërtuam atë. Gur më gur, të drejtë më të drejtë. Ne dolëm nga dekadat ku shteti dëgjonte vetëm veten dhe kundërshtimi ndëshkohej, nuk mbrohej. Në atë periudhë historike jo të largët, të jetuar nga shumë prej nesh, vetë ideja e një institucioni të pavarur që përballej me pushtetin në emër të qytetarëve, nuk ishte vetëm e ndaluar, **ishte e paimagjinueshme. Sot, ajo është kushtetuese.**

Avokati i Popullit nuk është një zbukurim për demokracinë tonë; është një garanci për jetësimin e saj. Edhe tani, kur besimi institucional është ende i brishtë, kur distanca mes qytetarit dhe shtetit mund të ndihet e madhe, nga njëra anë, dhe e pandjeshme, nga ana tjetër, është në fakt Avokati i Popullit i cili ecën në këtë distancë me misionin për t'i përafruar ata.

Të nderuar kolegë,

Kushtetuta jonë garanton të drejtat, por është Avokati i Popullit që siguron që ato të mos harrohen mes bojës dhe letrës së ligjeve dhe korridoreve të burokracisë.

Për shkak të forcës kushtetuese e ligjore rekomanduese që i është njohur Avokatit të Popullit, konsiderohet sot si një mjet efektiv për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe një mekanizëm i rëndësishëm për interpretimin dhe zbatimin e të drejtave kushtetuese, si dhe rivendosjen e së drejtës së shkelur nga institucionet publike.

Avokati i Popullit u konceptua nga vetë kushtetutëbërësi si organ kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për këtë qëllim atij iu njohën kompetenca të gjera hetimi, si edhe e drejta për të vënë në lëvizje vetë Gjykatën Kushtetuese, si mjeti i fundi kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individit.

Ndonëse fillimisht i përfshirë në subjektet që nevojitej të provonin interesin e tyre, ishte praktika e Gjykatës që dalëngadalë, në përputhje me rëndësinë e misionit dhe rolit të Avokatit të Popullit, zgjeroi aksesin e tij në gjykimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese dhe Avokati i Popullit, ndonëse me funksione dhe kompetenca të ndara, kanë një mision të përbashkët: **mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit nga veprimet e padrejta të organeve shtetërore, me qëllim ndalimin e arbitraritetit dhe abuzimit në ushtrimin e pushtetit shtetëror**. Kjo është arsyeja se përse Gjykata, gjithnjë e më shumë, në çështje që përfshijnë mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të qytetarëve, kërkon edhe marrjen e opinioneve këshillimore nga Avokati i Popullit, duke e konsideruar atë “**një mik të Gjykatës**”.

Gjykata Kushtetuese mbron Kushtetutën – kontratën mes popullit dhe pushtetit. **Por** ndërsa ne gjykojmë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe ankimet e individëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese,

Avokati i Popullit na kujton atë që ligji dhe drejtësia **nuk duhet të harrojnë kurrë: Njeriun pas parimit.**

Në një shoqëri që përpiqet të lërë pas hijet e autoritarizmit, Avokati i Popullit përfaqëson më shumë sesa mbikëqyrje. Ai është vetë kujtesa, është kambana që bie për institucionet, të cilat duhet t'u shërbejnë njerëzve, jo pushtetit.

Shëndeti i demokracisë sonë nuk matet me madhësinë e institucioneve apo me arkitekturën e komplikuar të ligjeve—por me mënyrën sesi trajtojmë më të dobët ndër ne. Dhe nëse Avokati i Popullit ndonjëherë ose shumë herë është i papëlqyer për pushtetin, kjo do të thotë se po e kryen misionin e tij siç duhet.

Për këtë arsye, institucionet tona duhet të punojnë në bashkëpunim – jo në garë. **Një demokraci e maturuar nuk ndërtohet mbi institucione që mbrojnë vetveten – por mbi institucione që mbrojnë ligjin, të drejtën dhe Kushtetutën, në mënyrë që së bashku të mbrojnë qytetarin.**

Ndaj u drejtohem të gjithëve që mbajnë poste publike, të gjithëve ne që kemi bërë betimin për të shërbyer:

Mos kini frikë nga zëri i Avokatit të Popullit!

Kini frikë heshtjen që do të ekzistonte pa të!

Mos e shihni Avokatin e Popullit si kritik, por si BUSULL!

Në përfundim, në këtë përvjetor të rëndësishëm, ju ftoj ta mbështesim së bashku këtë institucion jo me formalitet, por me respekt. Le ta forcojmë pavarësinë e tij – jo vetëm me fonde, por me përgjegjshmëri. Le t’u përgjigjemi raporteve të tij – jo me neglizhencë, por me dialog.

Dhe mbi të gjitha, le ta shohim Avokatin e Popullit jo si një të jashtëm (një outsider) të pushtetit, por si një **garant të legjitimitetit të tij**, sepse në një vend që ende shëron plagët e mosbesimit, nuk mund të lejojmë që të jetë i shurdhët ose të heshtë një nga zërat e pakët që flet për ata që nuk kanë zë.

Ta mbrojmë! Ta forcojmë Avokatin e Popullit jo vetëm për nevojën që kemi sot—por për një shtet shqiptar evropian të drejtë dhe social për të ardhmen!

Falemnderit!